



INSTITUTI ALB-SHKENCA
Tiranë – Prishtinë – Shkup

3 nëntor 2025

- Nga: Instituti Alb-Shkenca (IASH), me degë në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni të Veriut
- Për: Qeveritë e Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, Ministrinë e Arsimit dhe institucionet e kërkimit shkencor; Universitetet (publike dhe jopublike); Akademitë e Shkencave të Shqipërisë dhe të Kosovës
- Tema: ***Rekomandime për integrimin e diasporës shkencore shqiptare në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor gjithëshqiptar***
-

Instituti Alb-Shkenca, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Universitetin e Tiranës organizoi Takimin XX Vjetor Ndërkombëtar me temë: “Kontributi i Diasporës shkencore për integrimin në hapësirën evropiane të kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë gjithëshqiptar” më 26 – 27 shtator 2025. Ky dokument, bazuar në diskutimet gjatë Takimit XX, përfshin rekomandime konkrete për integrimin e diasporës shkencore shqiptare në arsimin e lartë dhe në kërkimin shkencor mbarëshqiptar, në funksion të rritjes së cilësisë dhe integrimin e institucioneve tona të arsimit të lartë në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA) dhe në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Fillimisht jepet një përshkrim i shkurtër i Institutit Alb-Shkenca (IASH). Pastaj preket shkurt kontributi i diasporës shkencore shqiptare në dy dekadat e fundit, para se të kalohet në rekomandimet konkrete për qeveritë/ministrinë, universitetet dhe institucionet shkencore përkatëse.

Këto rekomandime bazohen në përpjekjet për të përfshirë arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor gjithëshqiptar në kuadër të ERA dhe EHEA, si dhe në përputhje me dokumentet strategjike të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, përfshirë *Agjenda e Ballkanit Perëndimor për Inovacion, Kërkim Shkencor, Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (2023)*. Në këtë frymë, propozohet hartimi i Strategjisë Gjithëshqiptare të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor 2030, me pjesëmarrjen aktive të diasporës shkencore shqiptare.

I. Dy fjalë për Institutin Alb-Shkenca (IASH)

Instituti Alb-Shkenca zhvillon një veprimtari të gjerë në fushën e kërkimit shkencor e teknologjik dhe njëkohësisht punon për promovimin e kërkimit shkencor dhe për thellimin e bashkëpunimit mes kërkuesve shqiptarë kudo qofshin. IASH, si një organizatë shkencore mbarëshqiptare, organizon prej 20 vjetësh takime vjetore shkencore ndërkombëtare në kryeqendrat tona, në Tiranë, në Prishtinë dhe në Shkup, përmes degëve të tij gjeografike në tri shtetet përkatëse. Këtë vit IASH organizoi Takimin jubilar XX vjetor në Tiranë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe me mbështetjen e Universitetit të Tiranës dhe të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës, të Teknologjisë dhe të Inovacionit të

Republikës së Kosovës. Ndër vite, Instituti Alb-Shkenca ka bashkëpunuar ngushtësisht me UNDP Brain Gain Programme, Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) dhe Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës (FSHZHD), dhe më pas me Agjencinë Kombëtare të Diasporës (AKD), për të mundësuar kontributin e diasporës shkencore shqiptare në çështjet ekonomike, arsimore, kulturore, shëndetësore dhe gjithashtu në zhvillimin shkencor e teknologjik.

Instituti Alb-Shkenca, nderuar me “Shqiponjën e Artë” në Samitin I të Diasporës, realizon një veprimtari tërësisht vullnetare, dhe prej më se 20 vjetësh punon pa ndërprerje për bashkëpunimin mbarëshqiptar në fushën e arsimit dhe të shkencës, si dhe përfshirjes së diasporës shkencore shqiptare në zhvillimin socio-ekonomik të vendeve tona. Si një organizatë me degë të konsoliduara në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoni të Veriut, dhe me përfaqësi aktive në diasporën shkencore në Evropë, në Amerikë dhe në Australi, Instituti Alb-Shkenca vepron si një strukturë koordinuese mbarëshqiptare që ndërmjetëson bashkëpunimin akademik dhe shkencor ndërmjet institucioneve shtetërore, universiteteve dhe studiuesve të diasporës, duke garantuar koherencë dhe përparësi në agjendën kërkimore kombëtare.

II. Kontributi i diasporës shkencore shqiptare në 20 vjetët e fundit

Për më se dy dekada diaspora shkencore shqiptare ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm, shpeshherë nëpërmjet nismave individuale ose institucionale. Aktivitetet e Institutit Alb-Shkenca, përgjatë këtyre 20 vjetëve, duke bashkuar kërkuesit shkencorë nga Shqipëria, nga Kosova, nga Maqedonia e Veriut, dhe nga diaspora, përmes organizimit të Takimeve Vjetore dhe botimeve shkencore kanë shërbyer si urë e pazëvendësueshme lidhëse për shkëmbimin e eksperiencave të reja, duke i dhënë arsimit të lartë mbarëshqiptar një shtysë pozitive. Ndonëse kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë ka qenë kryesisht një veprimtari e varur nga nismat individuale, diaspora shkencore shqiptare ka kontribuar në:

1. **Përafrimin me standardet ndërkombëtare:** Përmes studimeve të pjesshme ose të plota pranë universiteteve perëndimore, falë programeve kombëtare dhe ndërkombëtare ose kombëtare, ose përpjekjeve individuale të specialistëve, është sjellë një cilësi e rritur në auditorët e universiteteve shqiptare.
2. **Integrimin në institucionet e arsimit të lartë:** Integrimi pas vitit 2000 në sistemin universitar publik dhe jopublik i studiuesve shqiptarë që kanë përfunduar studimet e doktoratës jashtë vendit ka krijuar një dinamikë të re.
3. **Zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe politikave arsimore:** Angazhimi i lektorëve shqiptarë në universitete të ndryshme evropiane në kuadër të marrëveshjeve si Erasmus+ ka ndikuar pozitivisht në këtë aspekt. Vlen të theksohet angazhimi i diasporës shkencore shqiptare në hartimin e dokumenteve të politikave (shiko hartimin e Dokumentit të Politikave për Arsimin e Lartë 2030, me mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtarë, dhe Raportin e Reformës së Arsimit të Lartë 2014, i cili studioi sisteme të ndryshme të arsimit të lartë në rajon, në Evropë dhe në vende të tjera).

Përforcimi i këtyre përvojave kërkon ndërtimin e një mekanizmi të përhershëm bashkërendues ndërmjet tri shteteve shqiptare dhe diasporës shkencore shqiptare. Në këtë drejtim, propozohet krijimi i një Platforme të Përbashkët të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shqiptar Mbarëshqiptar, e mbështetur nga IASH, që do të lehtësojë bashkëpunimin institucional, shkëmbimin e

ekspertizës dhe mobilitetin akademik ndërmjet universiteteve shqiptare dhe qendrave kërkimore ndërkombëtare.

III. Hapa konkretë për integrimin e diasporës shkencore

Gjendja e arsimit të lartë dhe e kërkimit shkencor në vendet tona është alarmante dhe në kushtet e një emergjence kombëtare. **Për të përballuar këtë situatë të rëndë duhet që të përpilohet një strategji e re mbarëkombëtare e arsimit të lartë dhe e kërkimit shkencor shoqëruar me plan veprimi konkret.** Strategjitë e mëparshme nuk kanë dhënë rezultatin e dëshiruar dhe grafiku rënës i studentëve të regjistruar në vitet e para, i cilësisë së botimeve dhe efektivitetit të ulët të projekteve shkencore vazhdon. Instituti Alb-Shkenca i ka kapacitetet e nevojshme dhe vullnetin e mirë për të kontribuar në përpilimin e një strategjie të re, integruese dhe më efektive. Si pjesë e kësaj strategjie duhen të trajtohen problemet e mprehta që lidhen me numrin e madh të universiteteve publike dhe jopublike, numrin tepër të madh të programeve Bachelor dhe programeve në nivelin Master të përgjithshëm të pa orientuar drejt specializimit, zvogëlimin e numrit të studentëve në degët themelore dhe mungesën e elementeve konkurrues e stimulues, dhe mungesën e universiteteve elitare që përmbajnë ato degë që i shërbejnë zhvillimit socioekonomik të vendeve tona. **Fuqizimi i disa universiteteve të rëndësishme së veçantë duhen të jenë prioritet i kësaj strategjie për të thithur elitën e maturanëve shqiptarë dhe atyre nga rajoni.**

Strategjia duhet të ketë në thelb ndërtimin e një ekosistemi kërkimor të integruar, ku institucionet e tri shteteve shqiptare të lidhen përmes rrjeteve të përbashkëta kërkimore, përmes projekteve ndërdisiplinore dhe përmes mobilitetit të ndërsjellë të studiuesve. **Në këtë kuadër, IASH mund të luajë rolin e një qendre koordinuese të veprimtarisë shkencore shqiptare, duke bashkuar ekspertizën kombëtare me atë të diasporës.**

Për të integruar plotësisht diasporën shkencore shqiptare në kërkimin shkencor dhe në arsimin e lartë mbarëshqiptar, qeveritë e Shqipërisë, të Kosovës, të Maqedonisë së Veriut, si dhe universitetet tona dhe institucionet kërkimore duhet të ndërmarrin hapa konkretë, të cilët tashmë reflektohen në strategjitë dhe objektivat e politikave, veçanërisht në Shqipëri, me fokus te zhvillimi i qëndrueshëm dhe integrimi në BE.

A. Roli i Ministrive dhe Agjencive përkatëse

- 1. Krijimi i mekanizmave të dedikuar:** Duhet synuar angazhimi afatshkurtër dhe afatgjatë i diasporës shkencore shqiptare në institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.
 - (i) Krijimi i një njësie të veçantë të Diasporës shkencore në Agjencinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI), që do të realizojë:**
 - Identifikimin e diasporës shkencore shqiptare, veçanërisht gjeneratën e re të talentuar dhe të doktoruar në universitete të njohura botërore.
 - Krijimin e regjistrave sipas profileve shkencore.
 - Krijimin e një Forumi (ose platforme) online për të stimuluar kontaktet nëpërmjet informacioneve të vazhdueshme.
 - Bashkërendimin me Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në vendet tona për t'i ftuar, përfshirë dhe angazhuar në proceset mësimore, kërkimore dhe vlerësuese, si dhe në projekte universitare kombëtare e rajonale. Shembulli i programit READ Albania

mbështetur nga AADF-ja dhe nga Qeveria Shqiptare është një model shumë i mirë që mund të ndiqet nga universitetet tona publike, në qoftë se ekziston vullneti i nevojshëm.

(ii) Ngritja e Qendrës Kombëtare të Teknikave Analitike, pjesë e infrastrukturës kërkimore, që do të realizojë krijimin e parkut të teknikave kryesore analitike e spektroskopike bashkëkohore që përdoren në kërkimin shkencor e teknologjik, si teknika të veçanta (por me kosto të lartë) të përqendruara në një Qendër, e hapur për të gjithë kërkuesit / studiuesit / studentët e doktoratës të të gjitha universiteteve publike dhe jopublike nga vendet tona dhe rajoni. Qendra duhet të ketë në përbërje të saj kryesisht kërkues, analistë dhe teknikë me përvojë, si dhe instrumente bashkëkohore për të kryer analiza të mostrave të mjedisit (të ajrit, të ujit dhe të tokës), ushqimore, biologjike e mjekësore, të mineraleve dhe të materialeve kritike e industriale dhe të materialeve të ngurta.

Qendra e Teknikave Analitike duhet të mbështesë kërkimin shkencor në të gjitha disiplinat e zhvillimit shkencor e teknologjik që kërkojnë studime laboratorike ose studime në terren. Këtu përfshihen shkencat e materialeve, kimia, biologjia, fizika, mineralogjia e gjeologjia, mjedisi, mjekësia, bujqësia, agrobiznesi, pyjet, ekosistemet ujore e të tjera.

Instituti Alb-Shkenca ka përgatitur një dokument ku paraqitet ideja e përgjithshme e kësaj Qendre Kombëtare, sistemet dhe pajisjet analitike e spektroskopike, pajisjet ndihmëse për përgatitjen e mostrave, analizat e shërbimet që do të ofrojë, si dhe hapat e procedurat që duhet të ndiqen për ngritjen dhe administrimin e kësaj qendre, pjesë e infrastrukturës kërkimore kombëtare e nivelit evropian.

- 2. Mbështetja financiare për bashkëpunim akademik:** Është e domosdoshme të investohet në **projekte të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimore**, si dhe në nisma për aplikim të përbashkët në fondet evropiane, në bashkëveprim të ngushtë me diasporën akademike shqiptare. Angazhimi i diasporës akademike shqiptare në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare është një kusht i nevojshëm për arritjen e objektivave kombëtare të forcimit të kërkimit shkencor dhe të inovacionit.
- 3. Nxitja dhe tërheqja e personaliteteve akademike nga diaspora:** Të krijohen kushte për tërheqjen e një personeli akademik sa më të kualifikuar, sidomos atij të diasporës shkencore, për të qenë të pranishëm në Shqipëri, në Kosovë, dhe në Maqedoni të Veriut, në forma të ndryshme, me qëllim që të rritet cilësia e arsimit të lartë dhe e kërkimit shkencor.

B. Roli i Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) dhe të Kërkimit Shkencor

1. Përfshirja konkrete në veprimtarinë akademike: IAL-të duhen të angazhohen konkretisht për të tërhequr diasporën shkencore shqiptare në forma të ndryshme bashkëpunimi, përfshirë:

- Pedagogë me kohë të plotë ose të pjesshme.
- Bashkautorë studimesh shkencore.
- Bashkudhëheqës ose mentorë të studentëve të doktoratës.
- Anëtarë komisionesh të doktoratave dhe të dhënies së titujve.
- Vizitorë me kohë të pjesshme, ose të ftohen për të marrë pjesë në seminare dhe në leksione të hapura.

2. **Ndërkombëtarizimi dhe standardet e cilësisë:** IAL-të duhen të mbështesin personelin akademik dhe të forcojnë bashkëpunimin me institucionet simotra të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor. Diaspora shkencore shqiptare mund të ofrojë ndihmë të veçantë në zhvillimin e programeve të reja të studimit në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe prioritetet kombëtare.
3. **Vlerësimi i cilësisë:** Duhet të rritet pjesëmarrja e diasporës shkencore shqiptare në proceset e vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të cilësisë, duke kontribuar në përmirësimin e standardeve kombëtare. Tërheqja e personelit akademik cilësor, përfshirë kuadrot e doktoruara në universitete të njohura evropiane dhe ndërkombëtare, përbën një nga objektivat themelore deri në vitin 2030, me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.

Përfundimi

Angazhimi i diasporës shkencore shqiptare është një garanci e rëndësishme për arritjen e objektivave të përafrimit të Shqipërisë, të Kosovës dhe të Maqedonisë së Veriut me Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA) dhe të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Integrimi i qenësishëm i arsimit të lartë dhe i kërkimit shkencor mes vetë Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, dhe përfshirja e Diasporës shkencore shqiptare krijojnë premisat e nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të vendeve dhe shoqërive tona. Arsimi i lartë shqiptar duhet të jetë i orientuar drejt inovacionit, cilësisë dhe gjithëpërfshirjes, dhe pa kontributin e Diasporës shkencore shqiptare, ky transformim është më i vështirë. Në qoftë se trupa jonë akademike mendohet si shqiponja jonë dykrenore, ajo nuk mund të jetë e plotë pa Diasporën shkencore shqiptare. **IASH mbetet i hapur për të diskutuar më konkretisht rekomandimet tona në lidhje me këto çështje themelore për zhvillimin evropian të kombit tonë, dhe për të ndihmuar në ngritjen e funksionimit e strukturave dhe institucioneve, për të realizuar ëndrrën e Shqipërisë evropiane në vitin 2030.**

Instituti Alb-Shkenca propozon që këto rekomandime të përfshihen në strategjitë kombëtare për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Shqipëri, në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut, dhe të konsiderohen si bazë **për memorandume bashkëpunimi ndërinstytucionale** me Komisionin Evropian dhe me rrjetet kërkimore ndërkombëtare. Ky proces do të garantojë që zëri i shkencës shqiptare të jetë pjesë aktive e vendimmarrjes akademike evropiane dhe të kontribuojë në përfaqësimin dinjitoz të diasporës shkencore shqiptare në forumet globale.

Në emër të Institutit Alb-Shkenca:

Gentian Zyberi, kryetar i përgjithshëm

Eshref Januzaj, zëvendëskryetar i përgjithshëm

Fatos Ylli, sekretar i përgjithshëm

Niko Qafoku, kryetar nderi

Ardian Maçi, kryetar i degës së Shqipërisë

Ali Caka, kryetar i degës së Kosovës

Zeqirja Neziri, kryetar i degës së Maqedonisë së Veriut